



REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT / AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE / ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. 03-02/DPK	Nr. Prot. 01-1968/16
Nr. I faq. 02	Pro. No. 01-1968/16
Broj stranica	Data 06-06-2016
Nr. pages	Data



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 03.06.2016, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-1024/16, për z. Latif Latifi, Anëtar i Kuvendit Komunal në Komunën e Mitrovices Jugore, për shkak se zyrtari i lartë publik e ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funkcionit Publik për zyrtarin e lartë, z. Latif Latifi, Anëtar i Kuvendit Komunal në Komunën e Mitrovices Jugore dhe njëkohësisht Laborant në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike në Universitetin e Mitrovices "Isa Boletini", është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Zyrtari i lartë, z. Latifi, fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit (DPKI-01-1109/16). Pas pranimit të kësaj shkrese kemi organizuar një takim me zyrtarin e lartë. Gjatë këtij takimi z. Latifi, është njoftuar me fakte për kufizimin e përcaktuar shprehimisht në Ligjin nr.03/L-149, për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, neni 75 (paragrafi 1), në të cilin shprehimisht thuhet:

“Nëpunësit civilë mund të mbajnë, përkohësisht, pozita politike. Gjatë mandatit të tyre në këto pozita, statusi i tyre i nëpunësit civil pezullohet për shkak të mospërputhshmërisë ndërmjet emërimit politik dhe statusit të nëpunësit civil”.

Zyrtari i lartë z. Latifi, ka premtuar se brenda afatit ligjorë do të ndërmarrë veprimet e nevojshme për të shmangur situatën e konfliktit të interesit.

Agjencia i ka bërë shkresë paralajmëruesë zyrtarit të lartë (DPKI-01-1706/16), me të cilën i është dhënë një afatë ligjor shtesë, brenda të cilës duhet të shmangët gjendja e konfliktit të interesit, përndryshe do të pasojnë masat tjera sanksionuese të parapara me ligj.

Ndërkohë, z. Latifi ka dërguar në Agjenci Vendimin për pezullim të marrëdhënies së punës, i nxjerr me datë 23.05.2016 nga Sekretari i Përgjithshëm i Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini”, në të cilën shkruan se pranohet kërkesa e z. Latif Latifi për pezullim të marrëdhënies së punës në funksionin Laborant, deri sa është duke ushtruar mandatin e Anëtarit të Kuvendit Komunal në Komunën e Mitrovicës Jugore. Me këtë rast z. Latifi e ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

